


Shërbimi i Securitë
Plenar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2025

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për një shtesë në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë””, shoqëruar me relacionin përkatës, propozuar nga një deputete e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DEPUTETE

Ina ZHUPA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2022

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 80/2015 “PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetes Ina Zhupa,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 124, pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me përmbajtje si më poshtë vijon:

Personat e diplomuar në programe studimi të përfunduar para përshtatjes së tyre sipas parimeve të procesit të Bolonjës, trajtohen nga ana administrative dhe financiare sipas nivelit të diplomës që kanë pasur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo përfshin diplomat e programeve 3-vjecare (6 semestra), të cilat njihen si diploma “Bachelor”, si dhe diplomat “Master profesional” me 60 ose 90 kredite ECTS, të cilat vazhdojnë të njihen dhe të trajtohen si diploma të nivelit të dytë për qëllime klasifikimi, pagese dhe avancimi në karrierë.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

Miratuar, më ____ . ____ .2025

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 80/2015 “PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon zbatimin në praktikë të parimeve të barazisë para ligjit, mosdiskriminimit dhe sigurisë juridike në mënyrën e trajtimit të mësuesve të arsimit parauniversitar. Si rezultat i ndryshimeve ligjore në legjislacionin për arsimin e lartë dhe përshtatjes me standardet e procesit të Bolonjës, 6200 mësues të arsimit parauniversitar janë të privuar sot nga trajtimi financiar dhe avancimi në karrierë, njësoj si kolegët e tyre, të cilët kanë përfunduar studimet pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 80/2015. Megjithatë neni 124 i Ligjit nr. 80/2015 ka synuar pikërisht rregullimin e kësaj situatë, në kushtet kur ligji nuk është shprehur sa i përket trajtimit administrativ dhe financiar, aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave kanë përcaktuar rregulla të ndryshme trajtimi financiar dhe avancimi në karrierë për këtë kategori profesionistësh të arsimit parauniversitar.

Në mënyrë të përsëritur, Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar (SBASH) ka adresuar shqetësimin e saj pranë Komisionit Parlamentar përgjegjës për Arsimin, Ministrisë së Arsimit, madje duke iu drejtuar edhe Gjykatës Kushtetuese, e cila për shkak të barazisë në vendimmarrje (katër pro, katër kundër), nuk arriti të japë një përgjigje përfundimtare lidhur me shqetësimin e mësuesve parauniversitarë. Në këto kushte, në vlerësim të eksperiencës së gjatë në edukimin e brezave, kontributin e cmuar profesional në sistemin arsimor, është e nevojshme që të ndërmerret një nismë ligjore që synon të garantojë një trajtim të barabartë, mosdiskriminues, meritokratik për mësuesit e diplomuar para aplikimit të sistemit të Bolonjës, me Ligjin nr. 80/2015. Në këtë mënyrë, Kuvendi i Shqipërisë kontribuon në lartësimin e statusit që duhet të gëzojnë të gjithë punonjësit e sistemit arsimor në Shqipëri, si një garanci për mirëedukimin e brezave të rinj.

Në të kundërt, mësuesve të arsimit parauniversitar të diplomuar përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 80/2015, iu cënohet trajtimi financiar, iu mohohet e drejta për të avancuar në karrierë, si dhe sjell një demotivim profesional dhe moral. Gjykata Kushtetuese është shprehur në mënyrë të përsëritur se siguria juridike presupozon, vec të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të çënojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimin nr. 31, datë 18.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, projektligji i propozuar synon mishërimin në praktikë të parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike, duke siguruar mosçënimin e të drejtave të fituara nga profesionistët e sistemit parauniversitar.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Mangësitë e evidentuara në nenin 124, të Ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, janë reflektuar edhe në aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave. Konkretisht, vendimin nr. 425, datë 26.06.2024 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet e arsimit dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”* ka prodhuar një trajtim administrativ dhe financiar të ndryshëm të punonjësve të arsimit parauniversitar, varësisht nga koha e diplomimit të tyre para ose pas ndryshimeve të vitit 2015. Kështu, të diplomuarit e programeve 3-vjecare (6 semestra) dhe të diplomuarit “Master profesional” për shkak të klasifikimit të tyre, kanë një pagë më të ulët, por gjithashtu iu pamundësohet lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë, për qëllime të avancimit në karrierë.

Kjo qasje është sigurisht diskriminuese, në kundërshtim me parimet e barazisë para ligjit, mosdiskriminimit, meritokracisë dhe sigurisë juridike, pasi mësuesit nuk vlerësohen në bazë të përvojës së tyre mësimore, kontributit profesional, performancës në punë, por varësisht nga periudha e kryerjes së studimeve dhe nëse i janë nënshtruar sistemit të Bolonjës gjatë studimeve të tyre apo ndonjë sistemi tjetër. Një qasje e tillë është tërësisht e papranueshme për Kuvendin e Shqipërisë, i cili duhet të synojë në çdo rast që të promovojë barazinë ligjore, mosdiskriminimin, sigurinë juridike, meritokracinë dhe zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë, si një kontribut për edukimin dhe formimin e brezave të rinj. Vetëm trajtimi me dinjitet i mësuesve, në drejtim të pagës dhe zhvillimit profesional, mund të mos jetë i mjaftueshëm për të siguruar arsimim cilësor të brezave, por është e sigurtë se pa një trajtim të tillë nuk mund të ekzistojnë as premiset për një arsim më cilësor.

Në këtë kuptim, çdo angazhim, investim apo kontribut në trajtimin dinjitoz të mësuesve parauniversitarë është një kontribut për mirëedukimin, zhvillimin, aftësimin dhe formimin e fëmijëve dhe të rinjve të vendit tonë. Prandaj, pikërisht me këtë qëllim, është propozuar një shtesë në Ligjin nr. 80/2015, përkatësisht në nenin 124 të këtij ligji, që parashikon shprehimisht trajtimin të barabartë dhe mosdiskriminues të mësuesve parauniversitarë për efekt të klasifikimit, pagesës dhe avancimit në karrierë. Në këtë mënyrë eliminohet plotësisht diskriminimi ndërmjet punonjësve arsimorë parauniversitarë, si dhe hiqet çdo barrierë për avancimin dhe zhvillimin profesional, duke i dhënë përgjigje dhe zgjidhje shqetësimit të ngritur me forcë në mënyrë të përsëritur nga 6200 mësues në të gjithë vendin, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar (SBASH). Ky qëllim realizohet nëpërmjet shtimit të pikës 4/1, të nenit 124, të Ligjit nr. 80/2015 që vendos shenjat e barazisë ndërmjet trajtimit para dhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 80/2015.

III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është propozim i një deputeteje të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Sic kemi

shpjeguar më lart, projektligji është në harmoni me nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga dy dispozita.

E para, sjell shtimin e pikës 4/1, në përmbajtje të nenit 124, të Ligjit nr. 80/2015, që barazon trajtimin administrativ dhe financiar të mësuesve parauniversitarë para dhe pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore me Ligjin nr. 80/2015. Të diplomuarit në programet 3-vjecare (6 semestra), që njihen si të diplomuar “Bachelor”, dhe ata me “Master Profesional”, do të trajtohen si diploma të nivelit të dytë për qëllime klasifikimi, pagese dhe zhvillimi profesional.

Ndërsa, neni i dytë parashikon hyrjen në fuqi, në përputhje me përcaktimin e bërë në nenin 84, pika 3 të Kushtetutës së Shqipërisë.

V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji sjell efekte financiare për Buxhetin e Shtetit, të cilat do të duhet të përlllogariten në fazën e marrjes së mendimit nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 82, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë.

D E P U T E T E

Ina ZHUPA

